

**ALBCONTROL SHA**  
**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

Për: Operatori Ekonomikë “Consulting & Management Albania” sh.p.k. me NIPT K82206013U me adresë: Rr. Kajo Karafili, Pll. Bimbashëve nr.1, shk. 1, Ap. 2, Tiranë, me përfaqësues ligjor z. Skënder Bedalli

Procedura e prokurimit: REF-75403-06-19-2018, me objekt: “Projekti i përgatitjes dhe publikimit të World Aeronautic Chart-ICAO 1: 1 000 000”, me fond limit 45 000 000 (dyzetë e pesë milion) lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës do të jetë: 9 (nëntë) muaj nga data e nënshkrimit të kontratës

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 13 Korrik 2018, ora 11:00.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike Nuk ka.

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Ofertuesi i parë: Operatori Ekonomikë “Consulting & Management Albania” sh.p.k, me NIPT K82206013U
  - Çmimi i ofertës: 28 888 000 (njëzetë e tetë milion e tetëqind e tetëdhjetë e tetë mijë) lekë pa tvsh
  
2. Ofertuesi i dytë: Bashkimi i Përkohshëm i Operatorëve Ekonomikë “Air Communication” sh.p.k. me NIPT L32409042E dhe ENAV S.P.A me NIPT 97016000586

- Çmimi i ofertës: 39 987 999 (tridhjetë e nëntë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa tvsh

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, Operatori Ekonomikë “Consulting & Management Albania” sh.p.k. me NIPT K82206013U me adresë: Rr. Kajo Karafili, Pll. Bimbashëve nr.1, shk. 1, Ap. 2, Tiranë, me përfaqësues ligjor z. Skënder Bedalli ka paraqitur ofertën me vlerë: 28 888 000 (njëzetë e tetë milion e tetëqind e tetëdhjetë e tetë mijë) lekë pa TVSH, e cila është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë ALBCONTROL SHA, me adresë në Aeroportin Nënë Tereza Rinas, pranë Zyrës së Prokurimeve, kopjen e nënshkruar të formularit të kontratës dhe të sigurimit të kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej /39 987 999 (tridhjetë e nëntë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë/], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 13.07.2018